



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 shkronja c) dhe 17 shkronja f) të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 15 dhe 34 të Ligjit Nr. 04/L – 060 për Mbeturina, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17 e datës 29.06.2012 dhe nenit 9 shkronja f) dhe 20 shkronja c) të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur me 29. 09. 2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është që Komuna në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina të rregulloj sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, orarin për mbledhjen e mbeturinave, llojin, numrin, përjashtimet, obligimet dhe të drejtat e gjeneruesve të mbeturinave, mënyrën e shpërndarjes dhe vendosjes së kontejnerëve për mbeturina, caktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale, kushtëzimin e ofrimit të shërbimeve, caktimi i vendit për deponimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyrat për transportim të mbeturinave.

II. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS

Neni 2 Detyrat e Komunës

1.Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbeturina, detyrat dhe përgjegjësitë e Komunës janë si vijon:

- 1.1. Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave i cili duhet të jetë në harmoni me planin nacional,
- 1.2. Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
- 1.3. Rregullimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimi i tyre, organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre,
- 1.4. Caktimi i tarifave dhe mënyra e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale,
- 1.5. Evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre dhe hartimi i projekteve për sanimin e tyre,
- 1.6. Zbatimi i procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e operatorit për mbledhjen,
- 1.7. Grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave në territorin e komunës.
- 1.8. Largimi dhe përkujdesja për mbeturinat të cilat janë hedhur në hapësirat publike ose jashtë deponive të mbeturinave në territorin e saj.

III. LLOJET E MBETURINAVE

Neni 3

Llojet e mbeturinave

1. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbeturina, llojet e mbeturinave janë:

- 1.1. Mbeturinat komunale,
- 1.2. Mbeturinat komerciale,
- 1.3. Mbeturinat industriale,
- 1.4. Mbeturinat medicinale.

2. Mbeturinat nga paragrafi 1 i këtij neni, varësisht nga ekspozimi i rrezikshmërisë janë:

- 2.1. Mbeturina inerte, që nuk ndizen, nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike, nuk treten, nuk kanë zbërthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut,
- 2.2. Mbeturina të vëllimshme, mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë,
- 2.3. Mbeturina të parrezikshme që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin,
- 2.4. Mbeturina të amvisërisë,
- 2.5. Mbeturina të veçanta nga mbetjet animale,
- 2.6. Mbeturina të rrezikshme.

Neni 4

Përfshirjet

1. Nga kjo Rregullore përfshihen mbeturinat në vijim:

- 1.1. Mbeturinat e rrezikshme dhe
- 1.2. Llumi/balta dhe mbeturina të ngjashme

2. Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë dispozitave ligjore të veçanta përkatëse.

IV. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Neni 5

Menaxhimi i mbeturinave komunale

- 1. Mbeturinat komunale duhet të mbledhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe me këtë Rregullore.
- 2. Krijuesit e mbeturinave janë të obliguar që mbeturinat ti hedhin në kontejnerë dhe jo jashtë hapësirave të kontejnerëve ose në hapësira tjera, si dhe të regjistrohen në regjistrin e shërbimeve të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
- 3. Subjektet e bizneseve të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme janë të obliguar që ta mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe përreth tyre.
- 4. Krijuesit e mbeturinave duhet që varësisht nga natyra e tyre ta bëjnë ndarjen e mbeturinave.
- 5. Të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë nxënësit - studentët në përputhje me rregullat bashkëkohore të trajtimit të mbeturinave.

V. KONTEJNERËT PËR MBETURINA

Neni 6

Kontejnerët për mbeturina

Komuna përcakton vëllimin, llojin, vendin dhe numrin e kontejnerëve të mbeturinave. Komuna do të kujdeset në vazhdimësi për sigurimin e kontejnerëve për secilën familje (kontejnerët për ekonomitë familjare) në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 7

Vëllimi i kontejnerëve

1. Vëllimi i shportave dhe kontejnerëve do të jetë si në vijim:

- 1.1. Kontejnerët me vëllim prej 1.1 m³,

- 1.2. Kontejnerët me vëllim prej 7 m³,
- 1.3. Kontejnerët me vëllim prej 120 – 240 l,
- 1.4. Kontejnerët nëntokësorë me vëllim prej 3 m³,
- 1.5. Shporta me vëllime të ndryshme të vendosura në trotuare dhe parqe.

Neni 8

Lloji i kontejnerëve

1. Kontejnerët mund të jenë:

- 1.1. Prej materialit metal i zinkuar,
- 1.2. Prej materialit plastikë.

Neni 9

Numri i kontejnerëve

1. Numri i kontejnerëve mund të jetë si në vazhdim:

- 1.1. Me vëllim prej 1.1 m³ mund të përdoret për 5 ekonomi familjare,
- 1.2. Kontejnerët me vëllim prej 7m³ mund të përdoren për 20 ekonomi familjare,
- 1.3. Kontejnerët me vëllim prej 1.1 m³ mund të përdoren për bizneset në formë individuale dhe të përbashkët,
- 1.4. Kontejnerët me vëllim prej 7 m³ mund të përdoren për bizneset në formë të përbashkët.

Neni 10

Vendi dhe lokacioni për vendosjen e kontejnerëve

1. Kontejnerët për hedhjen e mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukshme dhe ku nuk shkaktohen pengesa për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe komunikacionit.
2. Lokacionet për vendosjen e mbeturinave përcaktohen nga Komuna me Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave.

VI. ORARI PËR MBLEDHJEN E MBETURINAVE

Neni 11

Orari për mbledhjen e mbeturinave

1. Mbledhja dhe grumbullimi i mbeturinave duhet të bëhet nga ora 07:00 deri në ora 09:00 të mëngjesit në hapësirat brenda qytetit, kurse në pjesët periferike dhe fshatrat edhe gjatës ditës.
2. Komuna sipas nevojës autorizon operatorin që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit të paraparë.

VII.TARIFAT PËR MBLEDHJEN E MBETURINAVE

Neni 12

Caktimi i tarifave dhe mënyra e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale

1. Faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në baza mujore kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave më së largu me datën 10 të muajit vijues.
2. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit.
3. Tarifat e shërbimit të grumbullimit për të gjitha kategoritë e gjeneruesve të mbeturinave përcaktohet sipas tabelës në shtojcën A.
4. Shkalla e tarifës do të rishikohet nga Drejtorati për Shërbime Publike , çdo dy vjet në muajin qershor.

VIII. KUSHTËZIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Neni 13

Mënyra e kushtëzimit në ofrimin e shërbimeve

1. Nëse gjeneruesi i mbeturinave (përs gjeneruesi i mbeturinave (përs person fizik ose juridik) nuk e paguan faturën e tarifës së mbeturinave ose nuk ofron dëshmi se i ka të kryera obligimet, komuna me vendim të veçantë mund të aplikoj masa administrative ndaluese për të gjitha shërbimet komunale

IX. DEPONITË PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE

Neni 14

Pikat grumbulluese të mbeturinave

1. Komuna cakton vendin për grumbullimin e mbeturinave në vendbanimet jashtë zonave urbane.
2. Pikat grumbulluese për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 2.1. Të ketë sipërfaqe të mjaftueshme për mbledhje të mbeturinave,
 - 2.2. Të ketë infrastrukturën tekniko-ndërtimore dhe objektet tjera përcjellëse,
 - 2.3. Të ketë personel për pranimin e mbeturinave,
 - 2.4. Të ketë peshoren për matje të mbeturinave,
 - 2.5. Të ketë kontejnerë të mjaftueshëm për hedhjen e mbeturinave,
 - 2.6. Të ketë objekte apo hapësira të tjera të mbuluara për manipulim me mbeturina.

X.OBLIGIMET DHE TË DREJTAT E GJENERUESVE TË MBETURINAVE

Neni 15

Obligimet dhe të drejtat e gjeneruesve të mbeturinave

1. Gjeneruesit e mbeturinave duhet të paguajnë për shërbimet e ofruara në bazë të taksës/tarifes së miratuara nga Komuna.
2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
3. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
4. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikëshme, t'i ndajnë dhe t'i dorzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara.
5. Çdo gjenerues obligohet që t'i largojë mbeturinat që krijohen gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objektëve, nga hapësirat ose vendet publike.
6. Çdo gjenerues duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik dhe operatorin, për të siguruar një mjedis të pastër.
7. Të gjithë personat fizik dhe juridik që krijojnë mbeturina kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet për hedhjen e mbeturinave.
8. Gjeneruesit e mbeturinave detyrohen që mbeturinat t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga komuna.

XI. PËRZGJEDHJA E OPERATORIT DHE NDËRPRERJA E KRYERJES SË SHËRBIMEVE

Neni 16

Procedura e përzgjedhjes së operatorit

1. Operatori ekonomik që do të merret me mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave do të zgjidhet me procedurë të prokurimit.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbeturina.

Neni 17

Ndërprerja e kryerjes së shërbimeve

1. Ndërprerja e kryerjes së shërbimeve operatorit për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave bëhet në rastet kur operatori nuk iu përmbahet kushteve dhe obligimeve të përcaktuara në kontratë.
2. Me rastin e ndërprerjes së kontratës operatorit i ndalohet kryerja e shërbimeve për mbledhjen e mbeturinave.

XII. NDALESAT

Neni 18 Ndalesat

1. Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje ndalohet:

- 1.1. Hedhja e mbeturinave në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike,
- 1.2. Hedhja e mbeturinave në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë,
- 1.3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, terracat e banesave etj.),
- 1.4. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
- 1.5. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe, dhe në vende të tjera publike),
- 1.6. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, ose në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave,
- 1.7. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave,
- 1.8. Gjermimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar,
- 1.9. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave,
- 1.10. Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave,
- 1.11. Personat duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të mbeturinave.

XIII. ZBATIMI I RREGULLORES DHE MASAT NDËSHKUESE

Neni 19 Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e Rregullores kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Inspektori komunal i Mjedisit dhe Policia e Kosovës.

Neni 20 Masat për mosrespektimin e Rregullores

Për shkelësit e dispozitave të kësaj Rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjobë mandatore sipas udhëzimit administrativ MMPH-Nr.06/2018 për ndëshkimet me gjoba mandatore apo gjobat tjera të përcaktuara sipas Ligjit për mbeturina.

XIV. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 21

Procedura e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit të mjedisit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.011-5830 e datës 01.02.2016.

15 Nr. 352-47361
Lipjan, më 30. 09. 2020

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



SHTOJCA A- Tarifat e shërbimit

Nr.	<u>LLOJET E SHËRBIMIT</u>	<u>Tarifat në euro për muaj</u>
1.	Ekonomitë familjare	4.70 €
2.	<u>Subjektet e biznesit për kontenjerët me vëllim prej 1.1 m³ me kontenierë të përbashkët</u>	6.50-12,50 €
3.	<u>Subjektet e biznesit për kontenjerët me vëllim prej 1.1 m³ me kontratë të veçantë për kontenierë të veçantë</u>	10.82 € për një zbrazje
4.	Për kontenierë me vëllim prej 7 m ³	40,82 € për një zbrazje
5.	Për materiale inerte – kontejner me vëllim 7m ³	97 € për ton